



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:063150
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05509568

C-IV-13-0429

1. A G

Paditësit

2. Xh G

3. S G, të gjithë nga Ferizaj

kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit për NSH “17 Nëntori” Ferizaj (në likuidim), Rr. “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 20 mars 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. Padia e paditësve konsiderohet e tërhequr.

2. Paditësit i bartin vetë shpenzimet gjyqësore.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 6 mars 2007, paditësit kanë parashtruar padi ne Gjykatën Komunale ne Ferizaj për lirimin dhe dorëzimin e paluajtshmërisë, pjesës së ndërtesës –oborrit nga N.SH.”17 Nëntori”Ferizaj (ne likuidim) .

Gjykata Komunale ne Ferizaj me aktvendimin e saj Cnr.150/07 te datës 18.04.2012 shpalli veten in kompetente dhe me aktin përcjellës te datës 20.06.2012 lëndën e dërgoi ne DHPGJS.

Lënda ka marr numrin C-IV-13-429

Me 14 shkurt 2024, gjykata lëshoj për paditësit vërejtje për ta paguar taksën gjyqësore, duke i njoftuar paditësit se nëse taksa nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, padia do të konsiderohet e tërhequr.

Arsyetimi ligjor

Padia e paditësve konsiderohet e tërhequr.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh:

Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Paditësi konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së ka për detyrë që ankesës t'ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.

Ne vazhdim dispozita 253.5 parasheh:

Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.

Me 14 shkurt 2024, Gjykata përmes urdhrit kërkoj nga paditësit, që të bëjnë pagesën e taksës gjyqësore, duke i njoftuar se padia e tyre do të konsiderohet e tërhequr nëse ata nuk e paguan taksën gjyqësore.

Paditësve iu është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bëjnë pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor.

Paditësi ka për obligim ti paguajnë taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të Dhomës së Posaçme në lidhje me udhëzimin e KGJK-së nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore.

Vërejtja ishte pranuar nga njëri nga paditësit me datë 16.02.2024, mirëpo ai nuk u përgjigj brenda afatit të caktuar prej 15 ditësh, e as deri me vendosjen e këtij Aktvendimi.

Nga kjo gjykata konsideron se paditësit nuk kanë interes për çështjen juridike të tyre dhe se në rastin konkret sipas dispozitave ligjore padia konsiderohet e tërhequr.

Shpenzimet gjyqësore

Në pajtim me nenin 62.2 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), paditësit si palë të pasuksesshme do të mbulojnë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha

Gjyqtare